



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

1.1. HYRJE

Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën verilindore të Republikës së Kosovës dhe përfshin një sipërfaqe prej 633.86 km², që përbën rreth 5.8% të territorit të Kosovës. Pozita e saj gjeografike në luginën e lumit Llap, e kombinuar me tokat pjellore dhe kushtet e favorshme klimatike, krijon premisa të qëndrueshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Komuna kufizohet me komunat Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Obiliq dhe Leposaviq, gjë që ofron avantazh për shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Këta faktorë e pozicionojnë bujqësinë si një nga sektorët primar për zhvillimin ekonomik lokal dhe për rritjen e punësimit në zonat rurale.

1.2. SYNIMET PROGRAMORE

Në territorin e Komunës së Podujevës kultivohen kultura të ndryshme bujqësore, me theks të veçantë në kulturat lavërtare, pemët e imëta (mjedra, aronia, boronica, dredhëza), si dhe bimët mjekësore dhe aromatike. Këto kultura përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për rritjen e prodhimit vendor, diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Drejtoria e Bujqësisë, përmes planit të saj të punës, synon:

- Mbështetjen dhe avancimin e prodhimit bujqësor përmes subvencioneve komunale;
- Nxitjen e kultivimit të pemëve të imëta dhe bimëve mjekësore si kultura me vlerë të shtuar ekonomike;
- Përmirësimin e kapaciteteve të fermerëve përmes trajnimeve profesionale dhe këshillimit teknik;
- Rritjen e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe donatorët për projekte zhvillimore në bujqësi;

1.3. VIZIONI

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE- së duke respektuar Politikën e Zhvillimit Rural (PZHR) të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit i cili është i mbështetur nga fondet zhvillimore lokale, qeveritare dhe ndërkombëtare.

Komuna e Podujevës qendër e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore sidomos pemëve të imëta cilësore për Kosovën, rajonin dhe më gjerë.

1.4. OBJEKTIVAT E PËRGJITHME

- Edukimi i vazhdueshëm
- Përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural;
- Forcimi i zinxhirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- Mbështetja institucionale në përkrahjen e fermave, plantacioneve bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në komunën e Podujevës;
- Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe rritje të sipërfaqeve punuese me sistem të ujitjes në funksion të rritjes së rendimentit;
- Mbështetja e zhvillimit ekonomik të komunës përmes nxitjes së investimeve në fushat:
 - Pemëtari duke përfshirë pemët e imta (mjedra, dredhëza, manaferra, boronica dhe aronia);
 - Lavërtari;
 - Bletari;
 - Shpeztari dhe
 - Produktet e veçanta (kërpurdha, bimë medicinale dhe aromatike etj).
- Përfshirja sociale, uljen e varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale.

1.5. OBJEKTIVAT SPECIFIKE 2026:

Sektori pemëtarisë

Përkrahja e fermerëve për ngritjen e pemishteve moderne me pemë të imëta synon zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit vendor. Përmes kësaj mase do të mbështeten fermerët në modernizimin e pemishteve, rritjen e rendimentit dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimit. Për realizimin e kësaj mase, për vitin 2026 janë planifikuar mjete financiare në vlerë prej 40,000.00 €. Me këto mjete planifikohet të subvencionohen fermerët me:

- fidane të mjedrës, sistem të ujitjes dhe foli
- si dhe fidane të tjera.

Sektori i bletarisë

Rritja e kapaciteteve prodhuese për bletarët përmes përkrahjes me pajisje moderne synon zhvillimin dhe avancimin e sektorit të bletarisë. Përmes kësaj mase do të mbështeten fermerët-bletarë në përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e prodhimit dhe cilësisë produkteve të bletarisë. Për realizimin e kësaj përkrahjeje, në këtë sektor janë planifikuar mjete financiare në vlerë prej 50,000.00 €. Me këto mjete planifikohet të subvencionohen së fermerët me:

- Tel rrethues dhe mbrojtës të vendbletarisë
- Koshere

Ose me mjete të tjera në këtë sektor.

Sektori i shpezëtarisë

Përkrahja e fermerëve në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve prodhuese në sektorin e shpeztëtarisë synon përmirësimin e kushteve të prodhimit dhe rritjen e efikasitetit në këtë sektor. Përmes kësaj mase do të mbështeten fermerët në modernizimin e kapaciteteve dhe rritjen e prodhimit vendor. Për realizimin e kësaj përkrahjeje, është planifikuar buxhet në vlerë prej 20,000.00 €. Me këto mjete planifikohet të subvencionohen fermerët me:

- Inkubator për rritjen e zogjëve, ose me mjete të tjera në këtë sektor.

Përkrahja me mekanizëm bujqësor

Planifikohet ofrimi i përkrahjes me pajisje për mekanizëm bujqësor, me qëllim të rritjes së kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore përmes përgatitjes më cilësore, më efikase dhe më të standardizuar të tokës bujqësore. Për zbatimin e kësaj mase, është paraparë buxhet në vlerë prej 120,000.00 €. Me këto mjete planifikohet të subvencionohen fermerët me:

- Frezë për tractor
- Motokultivatorë me frezë
- Dhe makinë mjelëse

Ose me mjete të tjera në këtë sektor.

Subvencionimi i qumështit për litër

Mbështetja e fermerëve llapjan në sektorin e qumështit përmes pagesave direkte për çdo litër qumësht të prodhuar dhe të dorëzuar, me synim rritjen e prodhimit vendor, uljen e kostove të prodhimit, stabilizimin e të ardhurave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit blegtoral.

Promovimi i sektorit të bujqësisë

Promovimi i sektorit të bujqësisë në Komunën e Podujevës synon rritjen e vizibilitetit të prodhimit vendor dhe forcimin e rolit të fermerëve në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë kuadër, planifikohet organizimi dhe mbështetja e aktiviteteve promovuese, përfshirë pjesëmarrjen në panaire bujqësore, organizimin e ngjarjeve tematike si Dita e Mjadrës, Dita e Bletës, si dhe aktivitete të tjera me karakter promovues.

Mbështetja e përpunuesve lokal

Mbështetja e përpunuesve lokal synon forcimin e kapaciteteve përpunuese dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve vendore. Kjo mbështetje planifikohet të realizohet përmes krijimit dhe avancimit të lidhjeve bashkëpunuese me investitor potencial, me qëllim të nxitjes së investimeve, zgjerimit të tregut dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

2. AKTIVITETE TJERA NË KUADËR TË DREJTORISË:

- Raporti përfundimtar i korrje-shirjeve përzgjedhja e disa fermerëve më të suksesshëm në rendimentet e arritura;
- Këshillime rreth parapërgatitjes së tokës për mbjellje vjeshtore;
- Këshillimet në temat për mbjelljet vjeshtore;
- Kërkesa për shndërrimin apo ndërrimin e destinimit të tokave;
- Bashkëpunimi me organizatat (barnatore bujqësore) që të sigurojnë repromaterial (farë, pleh, mjete dezinfektuese) të cilat ju përshtatën kushteve tona ;
- Mbjelljet vjeshtore dhe përcjellja e tyre;
- Dhënia e këshillimeve të drejtpërdrejta etj;
- Kërkesa për regjistrimin me Numrin Identifikues të Fermerit (NIF);
- Këshilla në pemëtari rreth mbjelljes së llojeve të ndryshme të pemëve;
- Realizimi i mbjelljeve vjeshtore;
- Monitorimi në terren i subvencioneve të ndara gjatë vitit 2025;
- Këshillime me perimtarët që bëjnë kultivimin në serrë;
- Realizimi i planeve vjetore;
- Zgjedhja e fermerëve më të mirë të vitit tashmë festë tradicionale;
- Bashkëpunimi i mirë me MBPZHR , OJQ, Fakultetin e Bujqësisë etj;
- Pjesëmarrja në seminare dhe takime të ndryshme;
- Punë të përditshme në zyrë dhe punë tjera që janë në interes të Komunës.

Nr.prot 12-320/01-0010963/26

Podujevë, 20.02.2026

Drejtori i DBPZHR



Behram Latifi